



Drejtoria për Mbrojtje, Shpëtim dhe  
Shërbime Publike

Nr. \_\_\_\_ /2021 Dt. 06 /12/2021

# RAPORT VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2021

## Sektori i Shërbimeve Publike

QAJESETI ZLADNA - 01000 NO  
REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMUNA E DEÇANIT - OPSTINA DEÇANE - DEÇAN MUNICIPALITY

№ i dokumentit: Dh. M. Sh. Sh. Publike 41108  
№ i shërbimit: 09 Data: 06.12.21  
DEÇAN DEÇANE

E përgatiti :  
Shefi i Sektorit për Shërbime Publike  
Xhevat Lufaj



Miratoj  
Drejtori për D.M.SH.SH.P.  
Izet Zenuni

## HYRJE

Drejtoria për M.SH.SH.P në organizimin e saj ka dy sektor: Sektori për Mbrojtje dhe Shpëtim si dhe Sektori për Shërbime Publike


Sektori për Shërbime Publike në kuadër të organizimit dhe të strukturës së tij mbi punën dhe aktivitetet e ka te organizuar me zyrtaret e saj si: në fushën e menaxhimit të mbeturinave, zyrtar për ndërtim, zyrtar për Transportin Publik si dhe detyra e punë shtesë që dalin nga drejtoria.

Sektori i Shërbimeve Publike sipas planifikimeve vjetore primare ka qenë realizimi i projekteve në infrastrukturën rrugore, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e tyre, në menaxhimin e mbeturinave, mirëmbajtje dhe zgjerim të ndriçimit publik, ndërtimi i trotuareve, shesheve, ndërtim dhe mirëmbajtje të kanalizimit, mirëmbajtjen e varrezave publike si dhe ndërtimin e lapidareve të Dëshmorëve, kujdesi për hapësirat publike në tërë territorin e komunës së Deçanit, kanalizimin e qytetit dhe detyra tjera sekondare që dalin gjatë vitit. Po ashtu pjesë e aktiviteteve është edhe punët e përbashkëta që janë me ndërmarrjet komunale dhe regjionale siç është, Kompania NPL “Higjiena” ndërmarrja regjionale e ujësjellësit “Hidrodrini”, ndërmarrja regjionale për ujitje të tokave “Drini I Bardhë” po ashtu bashkëpunim dhe asistim ka pas edhe me KEDS - Njësia Deçan.

Koordinim dhe bashkërendim të punëve dhe aktiviteteve me theks të veçantë ka pasur me NPL “Higjiena” që shumica e punëve të menaxhimit të mbeturinave dhe mirëmbajtjes së hapësirave publike, mirëmbajtjen dhe rregullimin e varrezave dhe lapidareve të Dëshmorëve i ka te kontraktuara me kontratën “Në Shtëpi”.

Raporti vjetor i punës do të bartë në vete të gjitha punët e kryera në formë tabelare dhe grafike gjate gjithë vitit në mënyrë kronologjike ashtu si kanë qenë të planifikuara në vitin paraprak.

## Infrastruktura rrugore dhe mirëmbajtja gjatë vitit 2021



### 1. Asfaltimi i rrugëve me kontratën “Llot 2” – 2021

Nr.	Vendi dhe emri i rrugës	km
1.	Prilep, Rruga e “Rezistencës”	1.4
2.	Prilep, Rrugët e fshatit	1.64
3.	Beleg, Rruga “Vëllezërit Vishaj”	0.5
4.	Kodralli, Rruga “Shaq Avdija”	0.44
5.	Llukë e Epërme, Rruga “Nezir Kaqorraj”	0.6
6.	Llukë e Epërme, Rrugët e fshatit	1.36
7.	Maznik, rrugët e fshatit	2.79
<b><u>Gjithsej:</u></b>		<b><u>10.96 km</u></b>

## 1.1 Rrugët e asfaltuara me kontratën e Mirëmbajtjes Verore dhe Dimërore



<b>Nr.</b>	<b>Vendi dhe emri i rrugës</b>	<b>km</b>
1.	Jasiq i Ri, rrugët e fshatit	1.6
2.	Baballoq, rrugët e fshatit	1.3
3.	Carrabreg , rrugët e fshatit	2.0
4.	Isniq, rrugët e fshatit	1.5
5.	Lumbardh, rrugët e fshatit	0.5
6.	Maznik – Zhebel	2.0
7.	Prerja dhe rregullimi i asfaltit të dëmtuar në tërë territorin e Komunës së Deçanit	0.4
8.	Prerja e vegjetacionit	
9.	Pastrimi i rrugëve dhe trotuareve nga bora gjatë sezonës së dimrit	
10.	Hapja anësore e kanaleve përgjatë rrugëve në tërë territorin e K. së Deçanit	
<b><u>Gjithsej km rrugë</u></b>		<b><u>9.3</u></b>
11.	Jasiq i Ri, kanal i ujitjes	2.5
12.	Pobërgjë, kanal i ujitjes	1.6
13.	Lloqan, kanali i ujitjes	0.1
14.	Isniq, muri mbrojtës	0.06
<b><u>Gjithsej kanal :</u></b>		<b><u>4.2</u></b>

### 1.2 Rrugët e asfaltuara me kontratën “Asfaltimi i rrugicave të Deçanit”




Nr.	Vendi dhe emri i rrugës	km
1.	Deçan, asfaltimi i rrugicave të qytetit	3.2

### 1.3 Shëtitorja në rrugën “Manastiri”



Nr.	Vendi dhe emri i rrugës	m
1.	Deçan, rr. “Manastiri” shëtitorja, kanali, muri mbrojtës, ulëset si dhe ndriçimi – pjesa e parë;	550
	<b>Shënim:</b> Projekt në vazhdim, pjesa e dytë e shëtitores 2021/2022	300

### 1.4 Punët e kryera sipas kontratën “Rruga Qendër”



Nr.	Vendi dhe emri i rrugës	km
	Deçan, rruga R 107 (Rr. “Luan Haradinaj”)- Qendra e qytetit) Infrastruktura nëntokësorë duke përfshirë ujësjellësin, kanalizimin e ujërave të zeza, gypat e reshjeve atmosferike, rrjeti elektrik, rrjeti i telefonisë mobile, kabllot e internetit etj, zgjerimi, trotualet, ndriçimi dhe asfaltimi	2.2
	Deçan, kanalizimi i qendrës së qytetit	2.2

### 1.5 Penda në fshatin Vranoc



Vranoc – Ndërtimi i pendës, muri mbrojtës 200m si dhe kapërderdhësi 18 m
--

<b>Shënim:</b> Projekt në vazhdim edhe në vitin 2022
--

### 1.6 Rehabilitimi dhe ndërtimi i Ujësjiellit për 12 fshatra



Rehabilitimi dhe ndërtimi i ujësjiellit për 12 fshatra nga ujëmbledhësi në fshatin Drenoc deri tek burimi Gurrat e Hasan Agës, projekt i bashke financuar nga Komuna dhe MAPL.	
--	--

### 1.7 Elektrifikimi i bjeshkëve të Deçanit



Nr.	Vendi	km
	Bjeshka e Madhe- Hapja e trasesë, hapja e rrugëve malore për vendosjen e shtyllave, vendosja e 21 shtyllave metalike si dhe stabilimenti shpërndarës	4
	<b>Shënim :</b> Projekti në vazhdim 2022	


### 1.8 Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit dhe impiantit për fshatin Drenoc



Nr.	Vendi	m
	Drenoc, faza e parë - pastrimi i terrenit, ndërtimi i rezervarëve për grumbullimin e ujërave të zeza.	
	<b>Shënim:</b> Projekt në vazhdim	



## 1.9 Rruga Deçan-Plavë




Nr.	Vendi	km
	Trasimi i rrugës	5.0
	Shënim: Projekt në vazhdim	

## 2.0 Rruga në Bjeshkën e Strelcit



Nr.	Vendi	km
	Strelca, hapja komplet e rrugës, mbushja me zhavorr, urat	14

## 2.1 Shëtitorja e Lumëbardhit të Deçanit



Nr.	Vendi	m
	Vazhdim deri te penda, shëtitorja si dhe fillimi i punimeve nga Tahirsylaj e me lartë.	500

## 2.2 Asfaltimi i rrugicave në fshatin Irzniq



Nr.	Vendi	km
	Irzniq, asfaltimi i të gjitha rrugicave	3.3

### 2.3 Punët e kryera sipas kontratën “Mirëmbajtja e rrugëve të Bjeshkëve”



Nr.	Vendi dhe emri i rrugës	Km te krasitjes	Km trasim dhe gërryerje
1.	Prerja e vegetacionit, zgjerimi dhe gërryerja rr. “Degëzimi nga Rampa deri tek Bjeshka e Deçanit” si dhe “Stanishta e Kurvalles deri te “Stanishta e Zogut”	13.0	9.2
2.	Prerja dhe krasitja e degëve të pemëve që pengojnë rrugën në të dyja anët në aksin, gërryerje tek: “Rruga e Bjeshkës së Deçanit dhe Bjeshkës së Carrabregut” si dhe rr. “degëzimi nga Zalli i Rupes deri te Pllaqica e Vokshit” dhe “Rruga në Bjeshkën e Belles së Ulët”	15.5	2.5
3.	Prerja dhe krasitja e degëve të pemëve që pengojnë rrugën në të dyja anët dhe zgjerimi e gërryerja e rrugës ekzistuese në aksin: “Nga Laura te Bjeshka e Kurvalles”, rruga në “Bjeshkën e Prilepit” si dhe rruga në “Bjeshkën e Pleqes”	18.0	6.0
4.	Prerja dhe krasitja e degëve të pemëve që pengojnë rrugën në të dyja anët në aksin “Rruga në bjeshkën e Roshkodolit”	10.0	0

#### 2.4 “Shtrirja e rrjetit të ujësjellësit në Belle”



Nr.	Vendi	km
	Fshati Belle ndërtimi i rezervarit, shtrirja e gypave, kaptazha	1.0
	Shënim: Projekt në vazhdim	2.5- 3.0

#### 2.5 “Rruga Garda e Dukagjinit” - Kodrali



Nr.	Vendi	km
	Kodrali, zgjerimi, trasimi dhe mbushja me zhavorr, muri mbrojtës(120 m )	2.2
	Shënim: Projekt që vazhdon edhe në vitin 2022	

## 2. Mirëmbajtja dhe zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik



Komuna e Deçanit në tërë territorin e vet deri në vitin 2020 ka pasur rreth 23 % të shtrirjes së rrjetit të ndriçimit publik, ndërsa gjatë vitin 2021 ka bërë ndriçimin dhe shtrirjen e rrjetit mbi 70 % të territorit apo në gjatësi rreth 60 km.

Qyteti i Deçanit është i ndriçuar komplet, gjithashtu gjatë vitit 2021 është punuar në 15 fshatra të Komunës si: Strelle i Ulët, Gramaqel, Carrabreg, Glllogjan, Irzniq, Pobërgjë, Dranoc, Voksh, Beleg, Llukë e Epërm, Pozhar, Kodrali, Llukë e Ulët, Sllup, Dubravë, ndërsa projekte në vazhdim janë fshatrat: Strelle i Epërm, Isniq dhe Prokolluk.

Gjatë vitit 2021 është bërë edhe zëvendësimi i trupave ndriçues me ato trupa eficient e cila ka ndikuar në reduktimin e shpenzimeve të energjisë elektrike të ndriçimit publik.

Po ashtu me kontratën për mirëmbajtje të ndriçimit publik është bërë ndërhyrje edhe në institucionet arsimore, shëndetësore dhe komunale për evitimin e defekteve si dhe ndërrimin e ndriçimit nga sistemi i vjetër në ndriçimin LED.

### **3. Aktivitetet e Komunës bashkë me NPL “Higjiena” -Kontrata “Në shtëpi”**

Njëra ndër aktivitetet kryesore për vitin 2021, Komuna e Deçanit konkretisht Sektori për Shërbime Publike e ka pasur me Ndërmarrjen Publike Lokale “Higjiena” me punët e kontraktuara sipas kontratës “Në Shtëpi”.

Me poshtë do ti paraqesim punët dhe aktivitetet në shumë fusha së bashku me Higjienën si:

#### **3.1 Mirëmbajtja e hapësirave të hapura publike**



Mirëmbajtja e hapësirave publike duke përfshirë mbjelljen, ujitjen, mirëmbajtjen e mobilierisë urbane, riparimi i shtigjeve me kubëza, pastrimi dhe fshirja e rrugëve kryesore dhe trotuareve në qytet, vendosja e tabelave për emërtimin e rrugëve, kositja e parqeve si dhe pune me ekskavator sipas kërkesës së Drejtorisë për Mbrojtje, Shpëtim dhe Sh. Publike.

### 3.2 Dekorimi i qytetit për festat zyrtare dhe festa tjera



Dekorimi i qytetit për të gjitha festat zyrtare, vendosja e flamujve, ndërrimi i flamujve, vendosja e shtyllave të flamujve, dekorimi i qytetit për festat e fund vitit dhe dekorime tjera sipas kërkesës dhe nevojave nga D.M.SH.SH.P.

### 3.3 Mirëmbajtja e kanalizimit



Mirëmbajtja e kanalizimit të ujërave të zeza, gropave septike dhe nyjave sanitare në territorin e Komunës së Deçanit, zhbllokimi i pusetave dhe pastrimi i tyre, zbrazja e gropave septike, gërmimi, furnizimi, ndërrimi i gypave deri me funksionalizimin e plote të ujërave të zeza. Zhbllokimi dhe pastrimi i pusetave të kanalizimit të ujërave atmosferik. Vendosja e kapakëve të pusetave të kanalizimit të ujërave të zeza metalike dhe të betonit etj.

### 3.4 Mirëmbajtja e memorialëve të dëshmorëve



Plani për mirëmbajtjen e memorialëve të dëshmorëve, pastrimi, mirëmbajtja e tyre, mbjellja e barit në parqet e memorialëve, renovimi i pllakave të dëmtuara, mirëmbajtja e hapësirave gjelbëruese përreth kompleksit të dëshmorëve duke përfshirë prerja dhe kositja e barit, largimi i mbetjeve mes pllakave apo gurëve si dhe rregullimi i pemëve dekorative. Ndërrimi i ulëseve, vendosja e ulëseve të reja, shportat e mbeturinave si dhe mirëmbajtja e rrethojave etj. Mirëmbajtja e varrezave publike në gjithë territorin e komunës së Deçanit.



#### 4 Eliminimi i deponive ilegale



Gjatë vitit 2021 është bërë eliminimi i deponive ilegale, nivelizimi dhe bartja e tyre në vende të caktuara për deponim. Është bërë largimi i mbi 20 deponive ilegale, rrafshimi dhe mbjellja e barit në ato deponi ku ka qenë e nevojshme. Në disa deponi është bërë edhe rrethimi dhe njoftimet për mos hedhjen e mbeturinave.

#### 5 Punë dhe aktivitete tjera sipas D.SH.P.-së



Aktivitetet tjera gjatë vitit kanë qenë edhe detyra shtesë të pa planifikuara si: ndërhyrjet në pikat e rrezikut nga vërshimet, pastrimin e sallës së sportit dhe stadiumit në Deçan, pastrimi gjatë vitit i PGM-ve, kanalet e ujitjes, prerja e vegjetacionit etj.

## 6 Lapidare, Memoriale, Varreza të Dëshmorëve



Në vitin 2021 Drejtoria për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike, Sektori për Sh. Publike i ka kushtuar kujdes të veçantë lapidareve, memorialëve dhe varrezave të Dëshmorëve në ndërtimin dhe renovimin e tyre. Në vitin 2021 ka pasur projekte në vazhdim të vitit 2020 po ashtu edhe projekte të reja. Renovim ka pasur në Lapidarin në fshatin Lumbardh si dhe Irzniq, ndërsa si lapidare të reja të ngritura në: Belle, Lebushe, Strelle i Ulet dhe Carrabreg i Epërm. Ndërsa si varre të reja të ndërtuara ka pasur një në fshatin Prilep. Duhet cekur se mirëmbajtjen, pastrimin dhe kujdesin gjatë gjithë vitit për të gjitha memorialët në Komunën e Deçanit i ka kryer kompania NPL”Higjiëna”.

### Transporti Rrugor – Publik

Gjatë vitit 2021 është bërë përcjellja e rregullt e linjave të transportit publik urban dhe rural në qytetin e Deçanit dhe fshatrat e tij.

Është bërë vazhdimi i lejeve dhe licencave për taksitë dhe kombibusët që operojnë në Komunën e Deçanit. Mbikëqyrja dhe vendosja e shenjave të komunikacionit si ato horizontale ashtu edhe vertikale sipas planifikimeve dhe nevojave si në qytet ashtu edhe në fshatra.

Bashkëveprim dhe koordinim me Policinë në raste të veçanta dhe kërkesa të ndërsjella. Si dhe punë dhe detyra tjera sipas planifikimit gjatë vitit 2020.

## **PËRFUNDIM**

Drejtoria për Mbrojtje Shpëtim dhe Shërbime Publike – Sektori për Shërbime Publike gjatë vitit 2021 në kuadër të planifikimeve dhe detyrave që I ka pas ka përmbushur dhe realizuar në përgjithësi direktivat e dalura nga kryetari dhe planifikimi I vitit 2020 I bërë nga drejtoria.

Prioritet dhe vëmendje të veçantë I janë kushtuar ambientit, infrastrukturës rrugore, bashkëpunimit dhe koordinimit me NPL “Higjiena” rreth realizimit dhe përmbushjes së kontratës “Në Shtëpi” menaxhimit të projekteve që kanë qenë në kuadër të Drejtorisë dhe po ashtu detyra dhe punë shtesë gjatë periudhës së helmimeve në muajin Korrik dhe përballja me pandeminë Covid-19.

Pjesë e aktiviteteve kanë qenë edhe takimet ndër komunale, në nivelet tjera qendrore si me Asociacionin e Komunave të Kosovës, Ministrinë e linjës, Organizatat Qeveritare dhe jo qeveritare që kanë pasur të bëjnë me projektet e Komunës së Deçanit si GIZ, DEMOS, etj.

Vitit e ka karakterizuar pritja e palëve, kërkesat etj dhe dalja në teren për problemet e caktuara si rrugë, kanalizime, transport publik, mirëmbajtje dhe tema tjera që e lidhin punën e aktivitetin e Drejtorisë për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike.